



Bazuar në nenin 35 paragrafi 1.1 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), si dhe nenin 3.3 dhe nenin 12 të Rregullores nr.2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimeve dhe të Ndërmjetësuesve të Sigurimit, Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2014, miratoi:

RREGULLORE PËR LICENCIMIN E KOMPANIVE TË SIGURIMEVE DHE DEGËVE TË KOMPANIVE TË HUAJA TË SIGURIMEVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo Rregullore përcakton kriteret, kërkesat, procedurat dhe afatet, që duhet ndjekur për aplikimin dhe marrjen e licencës për çdo kompani të sigurimeve dhe degë të një kompanie të huaj të sigurimeve, të cilat do të referohen në këtë rregullore si *kompani të sigurimeve*, përveç rasteve kur në mënyrë specifike adresohet kompanie e sigurimeve e themeluar si subjekt i varur apo degë e kompanisë së huaja të sigurimeve.
2. Kjo Rregullore zbatohet për të gjitha subjektet që aplikojnë për licencim në BQK, për të ushtruar veprimtari të sigurimeve në Republikën e Kosovës.

Neni 2

Përkufizimet

1. Të gjitha termat e përdorur në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet në nenin 1 të Rregullores 2001/25 mbi Licencimin, Mbikëqyrjen dhe Rregullimin e Kompanive të Sigurimit dhe Ndërmjetësuesve të Sigurimit (në vijim: *Rregullore nr.2001/25*) dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje.
 - a) **Subjekt i varur** - nënkupton personin juridik të veçantë të themeluar nga kompania e sigurimeve ose personi juridik, që është nën kontroll të përbashkët me kompaninë e sigurimeve.
 - b) **Degë e kompanisë së huaj të sigurimeve** - nënkupton një person të licencuar nga BQK-ja për të ushtruar veprimtari të sigurimeve në Republikën e Kosovës, si degë e kompanisë së huaj të sigurimeve, e cila kompani ka selinë e vet kryesore dhe mban licencë për të ushtruar veprimtari të sigurimeve në një juridiksion tjetër jashtë Republikës së Kosovës.

- c) **Aksionar kryesor** – nënkupton personin i cili posedon interes të rëndësishëm në kompaninë e sigurimeve siç është përcaktuar me nenin 1 të Rregullores nr.2001/25.
- d) **Menaxher i lartë** - nënkupton, kryeshefin ekzekutiv, zyrtarin kryesor për financa, zyrtarin kryesor të marrjes në sigurim, zyrtarin kryesor për vlerësimin e dëmeve të kompanisë së sigurimeve, si dhe çdo person tjetër që i raporton drejtpërsëdrejti bordit të drejtorëve ose merr pjesë apo ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të kompanisë së sigurimeve; apo është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja. Në rastin e degës së kompanisë se huaj të sigurimeve, menaxheri kryesor i degës, zyrtari kryesor i marrjes në sigurim, zyrtari kryesor i vlerësimit të dëmeve dhe zyrtari kryesor financiar konsiderohen menaxher të lartë të degës.

Neni 3 **Kërkesat për aplikim**

1. Të interesuarit për t'u licencuar si kompani e sigurimeve duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara me Rregulloren 2001/25, këtë Rregullore dhe instrumentet tjera rregullative të lëshuara nga BQK-ja.
2. Aplikuesi duhet të kërkojë nga BQK-ja format e nevojshme të aplikimit dhe udhëzimet për plotësimin e tyre.
3. Aplikacioni i plotësuar duhet të nënshkruhet nga të gjithë aksionarët themelues dhe të dorëzohet në BQK, me prezencë fizike të përfaqësuesit me autorizim të aksionarëve themelues ose të kompanisë së huaj në rastet kur kompania e huaj aplikon për licencimin e degës në Kosovë. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Rregulloren 2001/25, me këtë Rregullore dhe instrumentet tjera rregullative të lëshuara nga BQK-ja.
4. Kërkesat për licencë për të themeluar dhe operuar me një kompani të sigurimeve ose një degë të kompanisë së huaj të sigurimeve, duhet të shoqërohen nga informacionet e mëposhtme:
 - a) Kopjen e noterizuar të aktit të themelimit dhe statutin, si dhe adresën e selisë qendrore në Republikën e Kosovës;
 - b) Certifikatën e regjistrimit të biznesit në Agjencionin për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë;
 - c) Lista e aksionarëve, lloji i aksioneve, të dhëna për vlerën nominale të aksioneve, përqindja e pjesëmarrjes në kapitalin aksionar dhe personat apo palët e mundshme të ndërlidhura;
 - d) Emrin, nacionalitetin, vendbanimin, kualifikimet dhe përvojën e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë të kompanisë së propozuar, duke përfshirë historikun afarist dhe

profesional për pesë (5) vitet e fundit, ndërsa për degë të kompanisë së huaj të sigurimeve kërkesa e këtij nënparagrafi aplikohet vetëm për menaxherët e lartë;

- e) Shumën e kapitalit të autorizuar dhe të zotuar të kompanisë së propozuar ose të degës së kompanisë së huaj të sigurimeve, duke përfshirë shumat të cilat janë paguar dhe burimin e kapitalit;
- f) Planin e biznesit që përfshin, ndër të tjera, planifikimet për strukturën organizative të kompanisë së sigurimeve të propozuar ose të degës së kompanisë së huaj të sigurimeve; produktet, primet dhe llogaritjet e tyre; funksionimi i auditimit të brendshëm; funksionimi i menaxhimit të rrezikut; sistemet e brendshme të kontrollit; sistemet e teknologjisë informative; llojin e parashikuar të veprimtarive të sigurimeve; pasqyrat e parashikuara financiare për tri (3) vite dhe nëse ekzistojnë pasqyrat financiare të audituara dhe raportin vjetor për tri (3) vitet e fundit. BQK-ja mund të nxjerrë procedura të brendshme për vlerësimin e planit të biznesit;
- g) Emrin, nacionalitetin, vendbanimin, historikun afarist dhe profesional për pesë (5) vitet e fundit dhe pasqyrat financiare të audituara për tri (3) vitet e fundit, sipas ligjeve të tjera të aplikueshme të çdo aksionari kryesor të kompanisë së sigurimit të propozuar;
- h) Për çdo drejtor ose menaxher të lartë apo aksionar kryesor të kompanisë së propozuar të sigurimeve ose të degës së kompanisë së huaj të sigurimeve, dëshminë zyrtare nga Gjykata që shpalos çdo dënim për vepra penale nga Gjykata Kompetente, dosjet personale të falimentimit, diskualifikimi nga ushtrimi i profesionit apo përfshirjen e kaluar ose të tashme në funksion menaxhues të ndonjë korporate ose organi tjetër sipërmarrës, që i është nënshtruar procedurave të paaftësisë paguese, nëse ka;
- i) Draft kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licencohet;
- j) Programi i planifikuar për ri-sigurimin;
- k) Programi për zbatimin e masave për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit;
- l) Në çdo rast kur paraqitësi i kërkesës është një kompani e huaj e sigurimeve, që propozon themelimin e një subjekti të varur ose të një dege në Kosovë, duhet të sigurohet një deklaratë nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë se nuk ka kundërshtim rreth fillimit të aktiviteteve të propozuara në Kosovë dhe se ushtron mbikëqyrje globale dhe të konsoliduar të veprimtarisë ndaj kompanisë së huaj të sigurimit përfshirë subjektin e varur apo degën e kompanisë së huaj të sigurimit, që kërkon të licencohet në Kosovë;
- m) Dëshmia e pagesës së tarifës për licencim;

n) Informacione tjera shitesë të cilat mund të kërkohen nga BQK-ja.

5. Dokumentacioni i ofruar duhet të jetë në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuar/noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet kompetente të një shteti të jashtëm, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të atij shteti të jashtëm dhe në përputhje me dispozitat e akteve ligjore përkatëse të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Procedura e vlerësimit të aplikacionit për licencë

1. BQK-ja kryen shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur në pajtueshmëri me kërkesat e Rregullores nr.2001/25, kësaj Rregullore dhe instrumenteve të tjera rregullative të lësuara nga BQK-ja.

2. Brenda tre (3) muajve nga data e pranimit të kërkesës së kompletuar, BQK nxjerr vendim me të cilin aprovon licencën paraprakisht apo refuzon atë. BQK-ja do ta njoftojë me shkrim aplikuesin për vendimin e marrë. Njoftimi për refuzimin do të shpjegojë arsyet në mbështetje të të cilave është refuzuar licenca.

3. Për qëllime të paragrafit 2 të këtij neni, kërkesa konsiderohet e kompletuar nga data kur BQK-ja vlerëson se aplikacioni është i kompletuar sipas kërkesave të Rregullores nr.2001/25, të kësaj Rregullore dhe instrumenteve të tjera rregullative të BQK-së. Për këtë datë aplikuesi njoftohet me shkrim nga BQK-ja.

4. BQK-ja brenda 10 ditë pune pas ditës së pranimit të aplikacionit e shqyrton atë bashkë me dokumentacionin përcjellës dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse aplikacioni është apo nuk është i kompletuar, si dhe për kërkesat tjera që konsiderohen të nevojshme për vlerësimin e aplikacionit nga ana e BQK-së.

5. Nëse aplikacioni dhe dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar, BQK njofton aplikuesin për mangësitë dhe i kërkon atij kompletimin e aplikacionit dhe/ose sqarime shitesë.

6. Nëse brenda 15 ditë pune pas njoftimit të BQK-së sipas paragrafit 5 të këtij neni aplikuesi nuk e kompletton dokumentacionin dhe/ose nuk ofron sqarime shitesë, BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit dhe vendos për refuzimin e kërkesës për licencë. Nëse brenda periudhës deri në 15 ditë kalendarike, aplikuesi kompletton dokumentacionin e kërkuar dhe/apo ofron sqarimet shitesë të kërkuara nga BQK-ja sipas paragrafit 5 të këtij neni, atëherë BQK-ja njofton me shkrim aplikuesin se kërkesa konsiderohet e kompletuar dhe se nga ky moment fillon llogaritja e periudhës sipas paragrafit 2 të këtij neni për vlerësimin dhe vendosjen lidhur me kërkesën për licencim.

7. Gjatë periudhës së vlerësimit të aplikacionit, pas njoftimit me shkrim për aplikuesin se kërkesa është kompletuar, BQK-ja mund të kërkojë informata shitesë sqaruese lidhur me

dokumentet e aplikacionit. Kërkesa për informata shtesë në këtë fazë nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës prej tre (3) muajsh për të vendosur rreth kërkesës për licencim.

8. Në çdo fazë para dhënies së licencës, BQK-ja mund të kërkojë ndryshimin e emrit të propozuar të kompanisë së sigurimeve, po që se vlerëson se një emër i tillë do të krijojë konfuzion për publikun apo për industrinë e sigurimeve.

9. Pasi të kompletohet aplikacioni për licencë, BQK-ja vlerëson të dhënat në aplikacion dhe dokumentacionin e dorëzuar, si dhe sipas nevojës verifikon ato;

10. Nëse e vlerëson të nevojshme, BQK-ja mund të organizojë takime me përfaqësuesit e autorizuar të aplikuesit për të diskutuar rreth kërkesave të BQK-së, të cilat mund të lidhen me strategjinë e parashikuar të tregut, objektivat e paraqitura të aplikuesit, planin e parashikuar të biznesit, politikat e propozuara për menaxhimin e rreziqeve të kompanisë, si dhe çështje të tjera, që BQK-ja i konsideron të nevojshme për vlerësimin e këtij aplikacioni.

Neni 5

Miratimi paraprak apo refuzimi i dhënies së licencës

1. BQK-ja paraprakisht miraton licencën nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Nëse plani i biznesit bazohet në analiza të sakta dhe në supozime të arsyeshme;
 - b) Nëse struktura organizative e kompanisë së sigurimeve të propozuar apo degës së kompanisë së huaj të sigurimeve do t'i lejojë BQK-së të ushtrojë mbikëqyrje efektive dhe të konsoliduar;
 - c) Primet e llogaritura dhe provizionet teknike/matematike janë të mjaftueshme dhe arsyetojnë mbulimin e aktiviteteve dhe rreziqeve të parapara të kompanisë së sigurimeve;
 - d) Kompania e propozuar do të veprojë në pajtueshmëri me të gjitha dispozitat e Rregullores 2001/25 dhe akteve të tjera të brendshme ligjore;
 - e) Kualifikimet, përvoja dhe integriteti i drejtorëve apo menaxherëve të saj të lartë janë të përshtatshme për planin e biznesit të kompanisë së sigurimeve të propozuar dhe aktiviteteve të sigurimit;
 - f) Aksionarët kryesorë, drejtorët dhe menaxherët e lartë të kompanisë së sigurimeve të propozuar janë të përshtatshëm dhe të duhur;
 - g) Nën-paragrafët e) dhe f) të këtij paragrafi aplikohen për degët e kompanive të huaja të sigurimeve vetëm sa i përket menaxherëve të lartë.
2. Përveç kushteve të përcaktuara në paragrafin 1 më lartë, miratimi paraprak i licencës lidhur me një subjekt të varur ose degë të kompanisë së huaj të sigurimeve bëhet nëse:
 - a) Kompania e huaj e sigurimeve është e licencuar për t'u angazhuar në veprimtarinë e sigurimit në juridiksionin ku gjendet drejtoria e saj qendrore;
 - b) Autoriteti mbikëqyrës ku ka selinë qendrore kompania e huaj e sigurimeve, ka dhënë pëlqimin me shkrim për dhënien e licencës së këtillë; dhe

- c) BQK-ja vlerëson se kompania e huaj e sigurimeve mbikëqyret në mënyrë adekuatë në bazë të konsoliduar globale nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës në shtetin amë. Autoriteti mbikëqyrës nga shteti amë, duhet ta pranojë me shkrim se është në dijeni të dhënies së licencës së re dhe pajtohet që t'i ofrojë informata BQK-së me kërkesë të saj.
3. Në rast të miratimit paraprak të një kërkesë për licencë, BQK-ja përcakton të gjitha kushtet për kompaninë e sigurimeve të cilës i jepet licenca për fillimin e operacioneve të saj. Këto kushte mund të përfshijnë:
- a) Pagesën e kapitalit fillestar që aksionarët duhet të bëjnë për kompaninë e sigurimeve;
 - b) Punësimin dhe trajnimin e personelit të kompanisë e sigurimeve;
 - c) Blerjen e pajisjeve operative dhe përcaktimin e sistemeve operative;
 - d) Marrjen me qira, blerjen ose zotërimin e lokaleve të kompanisë së sigurimeve;
 - e) Primet e llogaritura dhe provizionet teknike ose matematike të mjaftueshme për mbulimin e përgjegjësive të kompanisë së sigurimeve;
 - f) Kushtet e kontratës finale, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën është kërkuar të licencohet;
 - g) Angazhimin e një auditori të jashtëm dhe angazhimin e aktuarit;
 - h) Çdo kusht tjetër që BQK-ja e konsideron të nevojshëm.
4. Nëse brenda një (1) viti kompania e sigurimeve nuk vepron në përputhje me kushtet për marrjen e licencës për fillimin e veprimtarisë, miratimi paraprak i kërkesës do të revokohet.
5. BQK-ja do të refuzojë një licencë, nëse nuk përmbushen kriteret e përcaktuara me Rregulloren 2001/25 dhe këtë Rregullore apo nëse aplikuesi qëllimisht ka ofruar dokumentacion të falsifikuar, si dhe nëse vlerëson se lëshimi i një licence të këtillë do të:
- a) Rrezikonte qëndrueshmërinë financiare të kompanisë së sigurimeve të propozuar ose të industrisë së sigurimeve në përgjithësi;
 - b) Rrezikonte interesat e policembajtësve të kompanisë së sigurimeve të propozuar; apo
 - c) Zvogëlonte në mënyrë substanciale konkurrencën.

Neni 6

Licenca përfundimtare

1. Kompania e sigurimeve që ka marrë licencën paraprake, brenda afatit të paraparë me Rregulloren 2001/25 dhe kushteve të përcaktuara me vendimin për licencën paraprake.
2. BQK-ja para miratimit të licencës kryen një ekzaminim në vend të kushteve teknike dhe të sigurisë së ambienteve, në të cilat aplikuesi do të zhvillojë veprimtarinë e sigurimeve. Qëllimi i këtij ekzaminimi është të vlerësojë nëse subjekti në fjalë ka krijuar kushte për të përmbushur detyrimet e përcaktuara me kushtet teknike për fillimin e veprimtarisë.

3. Nëse BQK-ja përcakton se janë plotësuar kushtet përcaktuara me vendimin për licencën paraprake, do të japë licencën përfundimtare e cila është e paafatizuar në kohë dhe është e patransferueshme.

4. Licenca jepet për klasët e sigurimeve për të cilat aplikuesi ka kërkuar të licencohet dhe i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me Rregulloren 2001/25 dhe këtë Rregullore.

Neni 7

Degët dhe zyrat shtesë

1. Kompania e sigurimeve apo dega e kompanisë së huaj të sigurimeve duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja para se të hapë, mbyllë ose zhvendosë një degë, nëndegë ose zyrë në Kosovë.

2. Kompania e sigurimeve duhet të marrë miratimin paraprak me shkrim nga BQK-ja para se të themelojë ose hapë një degë apo zyrë përfaqësuese në ndonjë juridiksion tjetër jashtë Kosovës.

3. BQK-ja mund të nxjerrë udhëzime përmes të cilit përcakton procedurat për marrjen e miratimit paraprak me shkrim, si dhe për formën dhe përmbajtjen e kërkesës lidhur me hapjen dhe mbylljen e degëve, nëndegëve dhe zyrave përfaqësuese brenda apo jashtë Kosovës.

Neni 8

Shndërrimi i degës së kompanisë së huaj të sigurimeve në subjekt të varur

1. Kompania e huaj sigurimeve e cila ushtron veprimtari sigurimi në territorin e Republikës së Kosovës nëpërmjet degës së saj, në bazë të licencës së lëshuar nga BQK-ja, mund të shndërrojë degën e saj në një subjekt të varur.

4. Shndërrimi i degës së kompanisë së huaj të sigurimeve në subjekt të varur, mund të bëhet me kërkesë të vetë degës së kompanisë së huaj të sigurimeve ose nëse vlerësohet e nevojshme nga BQK-ja.

5. BQK-ja mund të kërkojë nga kompania e huaj e sigurimeve, që është licencuar për të operuar si degë në Kosovë, që ta shndërrojë degën në subjekt të varur të kompanisë së huaj të sigurimeve nëse:

- a) Ndodh ndonjë ndryshim material në pronësinë e kompanisë së huaj të sigurimeve apo strukturën organizative të saj për të cilën BQK-ja ka arsye të bazuara për shqetësim;
- b) Ekziston rënie materiale në gjendjen financiare të kompanisë së huaj të sigurimeve apo i nënshtrohet sanksioneve nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit amë, për shkelje materiale të ligjit;

- c) Konsideron se operacionet e degës së kompanisë së huaj të sigurimeve në Kosovë, mund të rrezikojnë stabilitetin financiar të sektorit të sigurimeve;
- d) Konsideron se mbikëqyrja nga autoriteti mbikëqyrës i vendit amë është joadekuate.

4. Procedura për shndërrim të degës së kompanisë së huaj të sigurimeve në subjekt të varur, zhvillohet njësoj sikurse të aplikimi për licencë të një kompanie të sigurimeve, në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje, me përjashtim të procedurës së miratimit paraprak e cila nuk aplikohet në këto raste.

5. Vendimi për shndërrimin e degës së kompanisë së huaj të sigurimeve, kur shndërrimi kërkohet nga kompania e huaj e sigurimeve, duhet të merret nga asambleja e përgjithshme ose organi tjetër kompetent i asaj kompanie të sigurimeve.

6. Në rastin kur kompania e sigurimeve kërkon që degën ta shndërrojë në subjekt të varur, kompania e sigurimeve duhet ta marrë edhe pëlqimin me shkrim nga autoriteti mbikëqyrës i shtetit ku është themeluar kompania amë e sigurimeve.

7. Pas aprovimit të shndërrimit dhe lëshimit të licencës së re, të gjitha të drejtat dhe obligimet e degës së kompanisë së huaj të sigurimeve i kalojnë subjektit të varur pasardhës.

8. Subjekti pasardhës duhet t'i bëjë ndryshimet e nevojshme në regjistrin e bizneseve dhe tek organet tjera.

9. Subjekti pasardhës duhet t'i informojë policëmbajtësit për ndryshimin, duke i njoftuar se është pasardhëse e degës së kompanisë së huaj të sigurimeve dhe se ky ndryshim nuk do të ketë kurrfarë pasoja për policëmbajtësit ekzistues të kompanisë.

Neni 9

Revokimi i Licencës

1. Përveç siç përcaktohet në nenin 15 të Rregullores nr.2001/25, BQK-ja mund ta revokojë licencën e një kompanie të sigurimeve edhe në rrethanat si në vijim:

- a) Nëse licenca është lëshuar në bazë të informacionit dhe dokumentacionit të rrejshëm;
- b) Nëse ka pushuar të merret me veprimtarinë e sigurimeve më shumë se 3 (tre) muaj.
- c) Nëse ka pasur ndryshim në aksionarët kryesorë pa miratimin e BQK-së.
- d) Nëse i licencuari është një degë e kompanisë së huaj të sigurimeve dhe kompania e huaj e sigurimeve, e ka humbur të drejtën për të ushtruar veprimtarinë e sigurimeve në vendin ku është vendosur zyra e saj qendrore;
- e) Nëse ka ndodhur bashkimi, shkrirja ose shitja e pjesës më të madhe të pasurisë së kompanisë së sigurimeve;

2. Vendimi i BQK-së për të revokuar licencën i komunikohet me shkrim kompanisë së sigurimeve, duke dhënë arsyet e vendimit.

Neni 10

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i secilës kompani të sigurimeve të licencuar për ushtrimin e aktivitetit të sigurimeve në Kosovë për sigurimet jo-jetë dhe jetë nuk mund të jetë më i ulët se 3'000'000.€ (tre milionë euro).

2. Aplikuesi për licencë të kompanisë së sigurimeve për të ushtruar veprimtari të sigurimeve në Republikën e Kosovës, para marrjes së licencës përfundimtare, duhet të depozitojë për këtë qëllim në BQK shumën e kërkuar të kapitalit themeltar me anë të këtij neni.

Neni 11

Burimet e Kapitalit

1. Aksionarët e kompanisë së sigurimeve i japin BQK-së informacion për burimin e kapitalit të paguar për themelimin e kompanisë së sigurimeve, si dhe për çdo shtesë të kapitalit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së sigurimeve.

2. Për të vërtetuar burimin e parave për kapitalin themeltar dhe shtesën e këtij kapitali në BQK, dorëzohet dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Për personat juridikë:

- Evidencë për burimin e krijimit të kapitalit, raporti i auditorit të jashtëm të pavarur, pasqyrat financiare vjetore, donacione/dhurata apo burime të tjera të destinuara për t'u përdorur në blerjen e aksioneve të kompanisë së sigurimeve;
- Vërtetim i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili jep të dhëna për bilancin e personit juridik dhe për përmbushjen e detyrimeve tatimore.

b) Për personat fizikë:

- Evidencë për burimin e krijimit të kapitalit si blerje ose shitje, donacione/dhurata, paga, depozita monetare në banka apo vërtetime të tjera për burimin dhe krijimin e kapitalit;
- Vërtetime që dëshmojnë përmbushjen e detyrimeve tatimore;

3. Kontributet për kapitalin e kompanisë së sigurimeve nuk duhet të burojnë nga kredi bankare dhe hua të tjera apo fonde, origjina e të cilave nuk mund të verifikohet dhe/apo është e paligjshme.

4. Me qëllim parandalimin e pastrimit të parave, BQK-ja për vlerësimin dhe verifikimin e dokumenteve të paraqitura nga aksionarët, mund të bashkëpunojë me Njësinë për Inteligjencë Financiare të Kosovës apo me ndonjë autoritet tjetër të lëmisë së zbatimit të ligjit në

Republikën e Kosovës. BQK-ja mund të kërkojë informacione shtesë nga aksionarët gjatë verifikimit të burimit të kapitalit.

5. Nëse prejardhja e kapitalit themeltar nuk është e qartë për BQK-në, kjo përbën bazë për refuzim të licencës.

Neni 12

Përshtatshmëria e aksionarëve

1. BQK-ja vlerëson përshtatshmërinë e aksionarëve kryesorë potencial, në lidhje me një aplikacion të ri për licencë të kompanisë së sigurimeve. Gjatë procesit të aplikimit, aplikuesi duhet të shpallë listën e të gjithë aksionarëve themelues, si dhe pronarëve përfitues, në rastet kur janë të ndryshëm. Burimet e fondeve të investuara në kompani nga ana e aksionarëve duhet të shpalosen për BQK-në në të gjitha rastet.

2. Çdo aksionar potencial duhet të jetë në gjendje të demonstrojë qëndrueshmëri financiare. Kjo përfshin dëshmi të përmbushjes me kohë të detyrimeve financiare të kaluara dhe një gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare. Secili aksionar i propozuar duhet të dorëzojë dokumentacionin valid, që vërteton pagesën me kohë të detyrimeve tatimore. Dokumenti i tillë duhet të jetë i lëshuar nga autoritetet kompetente tatimore jo më herët se 30 ditë nga data e aplikimit.

3. BQK-ja do të verifikojë në mënyrë të pavarur, të dhënat për përshtatshmërinë e aksionarëve që kontrollojnë kompanitë e sigurimeve. Ky autorizim përfshin mbledhjen e dëshmive dhe dokumenteve në procedurat formale sipas procedurave administrative përkatëse.

Neni 13

Kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur

1. Çdo aksionar kryesor, drejtor, menaxher i lartë si dhe aktuar i kompanisë së sigurimeve duhet të përmbushin kërkesat për 'i përshtatshëm dhe i duhur', në lidhje me pozicionin përkatës dhe duhet të aprovohen nga BQK-ja para se të angazhohen nga kompania e sigurimeve.

2. BQK-ja vlerëson nëse një person është i përshtatshëm dhe i duhur për të mbajtur pozicionin përkatës në kompani, bazuar në kriteret e mëposhtme:

- a) Verifikimi i së kaluarës penale;
- b) Integriteti, ndershmëria dhe përkushtimi në përmbushjen e detyrave të tij;
- c) Kompetenca, aftësi profesionale dhe gjykimi i shëndoshë në përmbushjen e detyrave të tij;
- d) Pavarësia në mënyrë që të mos cenohen interesat e kompanisë së sigurimit nga konflikti i interesit, që mund të krijohet gjatë ushtrimit të detyrës.

- e) Kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur janë të aplikueshme për personat e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni gjatë gjithë kohës së qëndrimit të tyre në pozitë në fjalë të kompanisë së sigurimit.

Neni 14

Kualifikimi i drejtorëve dhe menaxherëve të lartë

1. Çdo drejtor dhe menaxher i lartë i kompanisë së sigurimeve duhet të jetë i aftë dhe i përshtatshëm me reputacion të mirë, i cili duhet t'i plotësojë kriteret e përcaktuara nga BQK-ja lidhur me kualifikimet, përvojën dhe integritetin.

2. Një person nuk konsiderohet i përshtatshëm nëse i njëjti:

- a) Është dënua për ndonjë vepër penale me aktgjykim të formës së prerë me burgim prej gjashtë muajsh ose më shumë, dhe nuk i plotëson kërkesat e BQK-së për të qenë i përshtatshëm dhe i duhur;
- b) Është larguar nga posti i një kompanie të sigurimeve nga BQK-ja.
- c) Me vendim të organeve kompetente i është hequr ose pezulluar e drejta e ushtrimit të profesionit;
- d) Ka qenë drejtor ose menaxher i lartë i një kompanie të sigurimeve, licenca e të cilës është revokuar nga paaftësia e pagesës së obligimeve ose në një kompani të sigurimeve të likuiduar gjatë mandatit të tij.

3. Drejtorët dhe menaxherët e lartë duhet të kenë diplomë universitare në ndonjë nga fushat si në vijim: ekonomi, financa, sigurime, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante, si dhe të kenë së paku tri vite përvojë në fushën e menaxhimit të sigurimeve, të menaxhimit të institucioneve financiare apo të ndonjë biznesi të madhësisë së njëjtë.

4. BQK-ja në raste të veçanta mund të kërkojë të intervistojë individin në fjalë. BQK-ja gjithashtu vlerëson përshtatshmërinë e bordit të drejtorëve, si tërësi dhe jo vetëm anëtarët individual të tij. Po ashtu BQK-ja vlerëson kompetencën e ekipit të menaxhmentit të lartë, si dhe nëse çdo anëtar është i përshtatshëm dhe i duhur.

5. Kompania e sigurimeve sapo të vihet në dijeni të rrethanave të cilat tregojnë se ndonjë drejtor ose menaxher i lartë mund të mos jetë person i përshtatshëm dhe i duhur, duhet ta njoftojë menjëherë BQK-në.

Neni 15

Emërimi i drejtorëve, menaxherëve të lartë dhe aktuarëve

1. Asnjë person nuk mund të ushtrojë funksionin e anëtarit të bordit të drejtorëve, menaxherit të lartë apo aktuarit të një kompanie të sigurimeve nëse paraprakisht nuk është marrë aprovimi me shkrim nga BQK-ja.

2. Paragrafi 1 i këtij neni zbatohet për degën e kompanisë së huaj të sigurimeve vetëm në lidhje me menaxherët e lartë dhe aktuarit, në rastet kur dega e kompanisë së huaj të sigurimeve cakton aktuar të veçantë për degën në Kosovë.

Neni 16 **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregulla 4 mbi Ndryshimin e Rregullës për Licencimin e Kompanive të Sigurimit të Përgjithshëm dhe të Sigurimit të Jetës, e miratuar më 23 qershor 2005 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë Rregullore.

Neni 17 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas miratimit nga Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Kosovës

Bedri Peci